

LIGJ
Nr. 30/2012

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS NË FUSHËN E PËRFAQËSIMIT KONSULLOR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës në fushën e përfaqësimit konsullor.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 21.3.2012

Shpallur me dekretin nr. 7375, datë 9.4.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS NË FUSHËN E PËRFAQËSIMIT KONSULLOR

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës (më poshtë të referuara si “Palët”),

me qëllimin e vendosjes së raporteve institucionale dhe të bashkëpunimit si dy shtete të pavarura në fushën e përfaqësimit konsullor;

të udhëhequra nga dëshira për të zhvilluar marrëdhëniet shumëmiqësore ndërmjet dy vendeve në përputhje me parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara, si edhe në përputhje me parimet universale të së drejtës ndërkombëtare;

me dëshirën për të mbështetur forma të reja të bashkëpunimit me synim për zgjerimin dhe thellimin e bashkëpunimit të ndërsjellë të bazuar në parimet e përfitimit të ndërsjellë;

të vendosura për të intensifikuar dialogun lidhur me një numër të madh çështjesh të interesit të përbashkët ndërmjet të dyja vendeve përmes bashkëpunimit ndërmjet Palëve;

bazuar në nenin 8 të Konventës së Vjenës për marrëdhënie konsullore;

ranë dakord si me poshtë:

Neni 1

Palët angazhohen në përfaqësimin konsullor të ndërsjellë në ato shtete ku njëra prej tyre nuk ka përfaqësi konsullore.

Neni 2

Përfaqësimi konsullor përfshin mbrojtjen e interesave të shtetasve dhe ofrimin e shërbimeve konsullore në përputhje me legjislacionin e shtetit dërgues dhe atij pranues.

Neni 3

Kërkesa për përfaqësimin konsullor të njëres palë i paraqitet Palës tjetër në rrugë diplomatike, ku paraqiten fushat konkrete në të cilat është i nevojshëm përfaqësimi.

Pala së cilës i është paraqitur kërkesa do të bëjë një vlerësim të veçantë duke u nisur nga mundësitë fizike dhe administrative të secilës nga përfaqësitë konsullore në shtetet pritëse.

Nëse Pala së cilës i është paraqitur kërkesa jep miratimin e saj për përfaqësimin konsullor, njëra nga palët në marrëveshje ndërmjet tyre fillon procedurat për marrjen e pëlqimit të shtetit pritës.

Neni 4

Procedurat dhe rregullat e përfaqësimit konsullor do të përcaktohen në një protokoll veprimi, për çdo rast të veçantë përfaqësimi që lidhet ndërmjet ministrive të punëve të jashtme të Palëve, në përputhje me parimet e së drejtës ndërkombëtare dhe praktikat më të mira konsullore.

Neni 5

Kjo marrëveshje mund të ndryshohet në çdo kohë me pëlqimin e ndërsjellë të Palëve. Ndryshimet eventuale hyjnë në fuqi në përputhje me procedurën e vendosur në nenin 6 të marrëveshjes.

Neni 6

Kjo marrëveshje vlen për një periudhë të pacaktuar dhe hyn në fuqi nga data e marrjes së notës së fundit, me anë të së cilës Palët njoftojnë njëra-tjetrën për plotësimin e procedurave të tyre të brendshme ligjore.

Secila Palë mund të shfuqizojë këtë marrëveshje duke informuar tjetrën, përmes kanaleve diplomatike me një njoftim paraprak prej 6 (gjashtë) muajsh.

Bërë në....., më..... 2012, në dy kopje origjinale, në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze, me vlerë të barabartë. Në rast mosmarrëveshjes në interpretim, gjuha angleze ka përparësi.